

Jep pra një shenjë bashkë me shumë të tjerë dhe zëri yt do të dëgjohet!

Për ti hequr armët bërthamore nga sytë e tokës dhe për ta arritur një çarmatim progresiv dhe proporcional.

Për ta arritur nënshkrimin e kontratave paqësore dhe për ti nxitur qeveritë në një betim që mos të ushtrojnë më luftëra si mjete për zgjedhjen e konfliktit.

Për ta tërhequr vëmendjen e opinionit ndaj edhe formave tjera të dhunës (ekonomike, raciste, seksuale dhe religjioze), të cilat shpesh ushtrohen në mënyrë të fshehtë apo të maskuar. Kështu ne duam t'i dëgjojmë ata që vuajnë nga ndonjë mënyrë e kësaj dhune.

Si dhe për ta arritur një vetëdije globale për domosdoshmërinë e një paqeje të vërtetë duke refuzuar kështu çdo formë dhune që ushtrohet, ashtu siç është arritur deri më tani një vetëdije mbi ruajtjen e ambientit.

Marshi botëror në shifra Do të marshohet në 6 kontinente, rreth 90 shtete, në 160 mij kilometra, rreth 90 ditëve, në linje tokësore (me tren, autobus, motoqikleta e biçikleta) në linje detare si dhe ajrore. Marshi do të kalojë në zona klimatike të buta dhe mesdhetare si dhe në ato kontinentale, tropike, siberiane e deri tek klimat e stepës e të shkretëtirave. Nga stepat siberiane deri tek shkretëtira e Sahares dhe e Atacames (regjionit më të tharë të botës) deri në Antarktis. Brenda 90 ditësh marshi kalon dy herë të katër stinët në një lartësi mbidetare rreth 5000 metrash.

Në Evropë marshi do të organizohet gati se në të gjitha shtetet europiane ku **më 9 nëntor 2009** ai do ta arrijë Gjenevën pranë OKB-së. Aty pra më 9 nëntor do të bashkohet masa e njerëzve që marshojnë nga fillimi i marshit me pjesën tjetër të njerëzve që marshojnë nga ishulli ballkanik. Ja pra më poshtë qytetet me data të marshit ballkanik. Në Stamboll mbahet më 28 nëntor, pastaj vazhdon në Selanik më 29 dhe 30 tetor, e më pastaj **në Shkup më datën 31 tetor**, e nga aty **në Prishtinë më 1 nëntor**, Beograd më 1 dhe 2 nëntor, Sarajevë 3 dhe 4 nëntor, Zagreb 5 dhe 6 nëntor, Lubjanë 7 nëntor, Triestë 7 dhe 8 nëntor, Aviano dhe Vicenza 8 nëntor e pastaj arrihet Gjeneva më 9 nëntor.

Për informata më të hollësishme mbi marshin botëror mund të klikoni në ueb-faqet e mëposhtme:

www.worldmarchforpeace.org (edhe shqip) • www.theworldmarch.org:
ose mund te kontaktoni selvete thaqin: selvete@weltweitermarsch.ch

Marsh botëror për paqe dhe kundër dhunës



Që të dëgjohet zëri i miliona njerëzve të kësaj bote, të cilët dëshirojnë paqe dhe një përfundim të lutërave dhe dhunës së tyre!

Ftojme të gjithë ata njerëz, ato organizata, shoqata, parti politike, ndërmarrje e të tjera, që ti bashkëngjiten apo ta përkrahin këtë marsh botëror për paqe dhe kundër dhunës!

Pse? Sepse uria në botë mund të shuhej vetëm me 10 përqindëshin e shpenzimeve që jipen për armatim. Le të imagjinojmë që: sikur 30% apo madje 50% e këtyre shpenzimeve të zbatoheshin për t'i përmirësuar kushtet jetësore themelore, në vend që ato mjete të përdoren për shkatërrim.

Sepse për t'i ndalur luftërat dhe dhunën për njerëzimin do të thoshte njëherë e përgjithmonë me e lënë anash parahistorinë duke bërë një hapërim të madh drejt zhvillimit njerëzor.

Sepse neve na shoqëron fuqia e zërave të mijëra gjeneratave të mëparshme, të cilat kanë vuajtur nga pasojat e luftërave, duke tingëlluar përsëri jehona e zërave të tyre anë e mbanë botës, dhe gjithkund ku lufta ka lënë gjurmë me të vrarë, të gjymtuar, të zhdukur dhe të dëbuar. Sepse organizata ndërkombëtare «World without wars» (Bota pa luftëra) sjell një propozim i cili hapë rrugët e ardhmërisë dhe ka për qëllim që gjithkund me dialog ta zëvendësoj dhunën.

Sepse ka ardhur momenti për t'i dëgjuar edhe zërat e të padëgjuarve, pra të miliona njerëzve që nga nevojat e tyre nxisin një mbarim të luftërave. Kjo aspiratë mund të arrihet, nëse i bashkojmë të gjitha forcat e pacifizmit si dhe ato forma të cilat në mënyrë aktive synojnë paqe në mbarë botën.

Kur? Marshi fillon më 2 tetor të vitit 2009 në Zelandën e Re, pranë një statuje të Mahatma Gandhi-t dhe pikërisht në ditëlindjen e tij, të cilën ditë OKB-ja vitin e kaluar e ka shpallur si ditë ndërkombëtare të paqes. Ky marsh mbaron më 2 janar të vitit 2010 në vargmalet e Andeve pranë majes më të lartë Aconcagua në Amerikë, pranë parkut Punta de Vacas në Argjentinë.

Kush? Marshi botëror është një iniciativë e organizatës ndërkombëtare «Bota pa luftëra» e cila që 15 vite me radhë angazhohet aktivisht për pacifizëm dhe kundër dhunës. Por, ky marsh do të realizohet me bashkëpunimin e shumë të tjerëve, ku pjesëmarrja është e hapur për të gjithë personat, shoqata, grupime, parti politike, ndërmarrje dhe shumë të tjerëve, të cilët janë në përputhshmëri me qëllimin e këtij projekti. Gjithashtu ky marsh do të pasurohet nga iniciativa dhe ide të ndryshme, të cilat do të vijnë kohë pas kohe deri në momentin e realizimit. Do të jetë pra një marsh, i cili falë aktiviteteve do të zbatohet nga iniciativa të ndryshme gjithnjë e më shumë të larmishme. Prandaj ftojmë të gjithë për një pjesëmarrje aktive, kështu që secili i intersuar me kreativitetin si dhe fantazirat e tij në botë mund të kontribuoj në qytetin ku jeton dhe do të marshohet.



Mundësitë për pjesëmarrje janë të shumëllojshme, e gjithashtu edhe përmes internetit në mënyrë virtuale mund të ndihmohet e merret pjesë. Ky është një marsh i njerëzve dhe për njerëz, si dhe ai synon të arrijë një pjesë të madhe të popullsisë në botë. Prandaj ftojmë edhe të gjitha masmediat që ta bëjnë të njohur këtë marsh për paqe dhe kundër dhunës anë e kënd botës.

Qka? Në ato shtete e qytete ku marshohet mund të organizohen festivale, forume, konferenca, takime të ndryshme sportive, kulturore, shoqërore, muzikore, artistike, arsimore e të tjera. Edhe në këto momente janë duke u planifikuar qindra projekte nga shumë njerëz dhe organizata të ndryshme

Për se? Për ta demaskuar situatën e rrezikuar botërore që po na shpie dalëngadalë në një rrugë të verbër, tek luftërat ku mund të vijnë në përdorim edhe armët bërthamore. Kjo do të ishte katastrofa më e madhe njerëzore e të gjitha kohërave.

Për ti dëgjuar zërat e shumicës së njerëzve të këtij planeti, të cilët as nuk duan luftëra e as nuk shohin kuptim në armatime. Ne të gjithë vuajmë nga manipulimi i vetëm disa vetave. Ka ardhur koha që të gjithë ta sqarojnë pozitën e tyre.